



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 280/25, Datë 20.03.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 128 të mbajtur më datë 23.09.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** rekomandimi i Komisionit të Ankesave i nxjerrë me vendimin KA.nr.1007/24 i datës 21.05.2024, për Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë për programin; *Gjuhë shqipe dhe letërsi BA 240 ECTS*.
- II. Akreditohet për periudhën një (1) vjeçare (1 tetor 2024 - 30 shtator 2025) programi;
 - *Gjuhë shqipe dhe letërsi BA 240 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.*
- III. Numri i studentëve aplikohet vetëm për periudhën që mbulon akreditimi.
- IV. Obligohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjuhë shqipe dhe letërsi BA 240 ECTS</i>	Senad Neziri Shemsi Haziri Labinot Berisha Kamber Kamberi

Për këtë program të studimit *Gjuhë shqipe dhe letërsi, BA 240 ECTS*, KShC në mbledhjen 120 të mbajtur me 06 dhe 07.02.2024 kishte nxjerrë vendimin Ref.327/24 i datës 23.02.2024 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovës për akreditim të programit, duke konstatuar se aplikacioni nuk i plotësonte kriteret për bartësit e programit.

Mirëpo Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” pas pranimi të vendimit të KShC-së Ref.327/24 të datës 23.02.2024, brenda afatit ligjor kishte parashtruar ankesë me datë 22.03.2024 në Komisionin e Ankesave i cili pasi ka shqyrtuar ankesën, të njëjtën e kishte aprovuar pjesërisht dhe kishte rekomanduar që KShC të ndryshojë vendimin e saj Ref.327/24 i datës 23.02.2024.

KShC pasi ka pranuar vendimin me rekomandime nga Komisioni i Ankesave, në mbledhjen e 128 të mbajtur më datë 23.09.2024 ka aprovuar rekomandimin e Komisionit të Ankesave.

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” kishte parashtruar ankesë tek Komisioni i Ankesave në AKA dhe gjatë shqyrtimit të ankesës Komisioni kishte gjetur se KShC nuk kishte vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe se bartësi i programit Kamber Kamberi kishte ofruar dëshmi bindëse/të mjaftueshme se plotësonte kriterin e publikimeve shkencore të përcaktuar në Manualin e Akreditimit.

Pretendimi i ankesës provohet përmes të dhënave në linkun: [*The Study on Comparative and Intertextual Levels, as a Theoretical and Analytical Approach between the Two Novels "Leximtari", Bernard Shlink and "Lëvdatë për Njerkën", Mario Vargas Llosa; 2023-01-05 - Vol. 13 No. 1 \(2023\): January 2023.*](#)

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen 128 të mbajtur më datë 23.09.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” dhe rekomandimin e Komisionit të Ankesave të AKA duke konstatuar se gjetjet e Komisionit janë të bazuara dhe vonesat në procesi të akreditimit kishin ndodhur pa fajin e institucionit, prandaj dhe vendosi që të aprovojë rekomandimin e komisionit të ankesave duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”;
- *MASHTI*;
- *Arkivit të AKA-së.*


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

